

**VENDIM**  
**Nr.67, datë 28.1.2008**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË PESHKOPI TË QARKUT TË DIBRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Peshkopi të qarkut të Dibrës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Peshkopi të qarkut të Dibrës, miratuar me vendimin nr.667, datë 4.10.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në bashkinë e Peshkopisë të qarkut të Dibrës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Peshkopisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**

**Sali Berisha**

Bashkia Peshkopi

Lidhja 1

| <b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>                                     | <b>Fusha e përdorimit të pronës</b>                                            | <b>Lloji i transferimit</b> |
|---------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------|
| 1-4,7-35                                                                                    | Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.                        | Në pronësi                  |
| 59                                                                                          | Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.            | Në pronësi                  |
| 64-84,86-91                                                                                 | Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.   | Në pronësi                  |
| 152-154                                                                                     | Varreza publike.                                                               | Në pronësi                  |
| 98                                                                                          | Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.                                |                             |
| 141-143,155-172,188,189,196,201,202,242-248,363,592-662,666,828                             | Infrastrukturë (troje të lira).                                                | Në përdorim                 |
| 151,173-187,190-195,197-200,203-241,249-362,364-591,746,752,755,829,830,1114-1333,1395-1403 | Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).         | Në pronësi                  |
| 121,122,123,125,126,148-150,668,673-675,677,721,732-753,755-762,                            | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. | Në pronësi                  |

|                                                                         |                                                                                                      |            |
|-------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------|
| 772-<br>777,819,820,822,823,826-<br>828,839,840,842,878-<br>884,909,910 |                                                                                                      |            |
| 980-994                                                                 | Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik. (Prona të bujqësisë). | Në pronësi |
| 127,132,136,137,139,140                                                 | Prona që përdoren në fushën administrative.                                                          | Në pronësi |
| 911-978                                                                 | Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile.                                     | Në pronësi |